

forcat serbe e nisën sulmin ndaj fshatit, kushërinjtë Shiqeriu, Haxhiu dhe Albani, së bashku me një grup burrash, shkuan në pyll me qëllim kalimin në fshatin fqinj të Kotorrit/Kotore. Te vendi i quajtur *Kroi i Smakës/Smakin izvor*, ata hasën në forcat serbe, të cilat menjëherë shtënë drejt tyre. Burrat u shpërndanë në të gjitha anët. Pas dy javësh, banorët e fshatit dhe ushtarët e UÇK-së e organizuan kërkimin e tyre. I kanë gjetur trupat e Shiqeriu, Haxhiut dhe Albanit përmbi *Mëhallën Ahmeti [Radishevë/Radiševo]*. Më 12.08.1998, ata u varrosën afër vendit ku u gjetën. Pas lufte, më 11.09.1999, mbetjet e tyre mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Radishevë/Radiševo.

Burimet: deklarata H.A, FDH-35018; deklarata R.A, FDH-35019; deklarata P.H, FDH-20346; deklarata V.T, FDH-18998; deklarata S.S, FDH-6780; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Seven Albanians Killed Sunday in Serb Offensive Identified*, pasqyra e lajmeve, KIC, 04.08.1998, FDH-29391.

Miradije (Bislim) Tahiri

(8.05.1956, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, katër fëmijë)

Kur, më **25.07.1998**, filloi beteja ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në Radishevë/Radiševo, familja e Miradijes iku në pyll, përderisa ajo ndenji në shtëpi. Pas tri ditësh [28.07.1998], kur forcat serbe u larguan nga fshati, familjarët e saj u kthyen në shtëpi por nuk e gjetën Miradijen. E gjetën trupin e saj të pajetë pranë çezmës së fshatit [**Radishevë/Radiševo**]. E kishin qëlluar me plumb në kokë. Në të njëjtën mbrëmje, familja e ka varrosur Miradijen në afërsi të çezmës. Pas lufte, më 15.10.1999, mbetjet e saj mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshat.

Burimet: deklarata E.T, FDH-16649; deklarata S.S, FDH-6780; deklarata V.T, FDH-18998; *Albanian Woman Found Dead and Buried in Radisheva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.08.1998, FDH-29446.

Ramadan (Halim) Tahiri

(1.05.1958, shqiptar nga Radisheva/Radiševo,

komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ramadani punonte në kooperativën lokale bujqësore. Në mëngjes, më **25.07.1998**, kur forcat serbe depërtuan në **Radishevë/Radiševo**, Ramadani u nda nga familja dhe me një grup burrash u nisën drejt fshatit fqinj të Kotorrit/Kotore. Atë ditë, kushërinjtë Murseli, Hajrizi dhe Sokoli herën e fundit e shihnin atë të gjallë. Burrat e fshatit kanë organizuar më vonë kërkimin për Ramadanin, por pa sukses. Familjarët nuk kanë kurrfarë njohurish për fatin e tij. Zhdukja e tij nuk i është paraqitur KNKK-së.

Burimet: deklarata H.T, FDH-16648; deklarata S.S, FDH-6780; deklarata V.T, FDH-18998; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Multilated Bodies of Albanians Found in Skenderaj and Decan Areas, Buried over Weekend*, pasqyra e lajmeve, KIC, 16.11.1998, FDH-30650.

Sabit (Sadri) Ahmeti

(5.01.1972, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, student, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Beqir (Muje) Hajrizi

(10.05.1938, shqiptar nga Kotorri/Kotore, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, njëmbëdhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Azem (Beqir) Hajrizi

(10.04.1966, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Faik (Beqir) Hajrizi

(13.10.1970, shqiptar nga Kotorri/Kotore, komuna e Skënderajt/Srbica, profesor i teknologjisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Sabiti ka lindur në Radishevë/Radiševo, por jetonte në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Ka marr pjesë në luftën e Kroacisë. Menjëherë pas themelimit të UÇK-së, e ka veshur uniformën e saj. Faiku u bë pjesëtar i UÇK-së në muajin mars të vitit 1998, ndërkaq i ati Beqiri dhe vëllezërit Azemi dhe Petriti më 15.04.1998. Kur forcat serbe e sulmuan Radishevën/Radiševo më **25.07.1998**, Sabiti e ka zhvendosur familjen e vet në fshatin fqinj të Kotorrit/Kotore. Atje u takua me Beqirin, Azemin, Faikun